

URDHËR
Nr. 370, datë 11.6.2019

**PËR MIRATIMIN E STATUTIT TIP TË ORGANIZATËS SË PËRDORUESVE
TË UJIT**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës, në nenin 25, pika 3, të ligjit nr. 24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”, me propozimin e Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural,

URDHËROJ:

1. Miratimin e statutit tip të Organizatës së Përdoruesve të Ujit (OPU), sipas modelit bashkëlidhur.
2. Organizatat e Përdoruesve të Ujit mund të parashikojnë në statutet përkatëse dispozita më specifike, me qëllim mbarëvajtjen e veprimtarisë së tyre, por pa rënë në kundërshtim me parashikimet e këtij statuti tip dhe të legjislacionit në fuqi.
3. Statutet e OPU-ve do të përshtaten me ndryshimet e legjislacionit, të cilat, në rast se bien në ku ndërshtim, prevalojnë mbi parashikimet statutores.
4. Për zbatimin e këtij Urdhri ngarkohen Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural dhe OPU-të.
5. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL**
Bledar Çuçi

STATUTI I ORGANIZATËS SË PËRDORUESVE TË UJIT

OPU _____ Bashkia _____ Qarku _____

KAPITULLI I
EMRI DHE VENDNDODHJA E ORGANIZATËS

Neni 1
Krijimi i organizatës

Organizata e Përdoruesve të Ujit _____, krijohet si organizatë jofitimprurëse. Ajo do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, ligjin nr. 8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, ligjin nr. 24/2017, datë 9.3.2017 “Për administrimin e ujitjes dhe kullimit”.

Neni 2
Emërtimi dhe selia

Emërtimi i organizatës është “Organizata e Përdoruesve të Ujit _____”, emri i shkurtuar është OPU _____.

Selia e organizatës ndodhet në adresën _____ njësia administrative _____ bashkia _____.

Neni 3

Zona e shërbimit nën ujitje e organizatës

1. Organizata krijohet në bazën e sistemit të ujitjes _____ me një sipërfaqe totale nën ujë prej _____ ha, siç përshkruhet në hartën bashkëngjitur në shtojcën A të këtij statuti.
2. Sipërfaqja e shërbimit të organizatës është ndarë në _____ zona, të cilat janë paraqitur në hartën bashkëngjitur në shtojcën A të këtij statuti.
3. Organizata shfrytëzon dhe mirëmban infrastrukturën e ujitjes të transferuar në përdorim brenda zonës së saj të shërbimit nën ujitjes.
4. Zona e shërbimit nën ujitje përfshin fshatrat në territorin: _____.

Neni 4

Vula e organizatës

Organizata do të ketë vulën e saj me përshkrimin: Organizata e Përdoruesve të Ujit _____, (OPU _____).

KAPITULLI II

OBJEKTIVAT, TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORGANIZATËS

Neni 5

Qëllimi i organizatës

1. Qëllimi i krijimit të organizatës është shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes të transferuar në përdorim, brenda zonës së saj të shërbimit të ujitjes dhe sigurimi i ujit për ujitje anëtarëve të saj.

Organizata i shërben interesave publike dhe interesave të anëtarëve të saj.

2. Objektivat e organizatës janë:

- a) të shfrytëzojë dhe mirëmbajë infrastrukturën ujitëse në përdorim, brenda zonës së saj të shërbimit;
- b) të marrë ujë për ujitje nga burimi ujor _____ sipas një marrëveshje me bashkinë _____/ Drejtorinë e Ujitjes dhe Kullimit _____;
- c) të furnizojë me ujë për ujitje në kohën dhe sasinë e duhur anëtarët e organizatës, të cilët janë pronarë ose përdorues toke brenda zonës nën ujitje;
- d) të përmirësojë praktikën e manaxhimit të ujit për furnizim me ujë në mënyrë të barabartë të gjithë fermerëve;
- e) të ndërmarrë iniciativë për rehabilitimin dhe modernizimin e nevojshëm të skemave të ujitjes për të arritur qëllimet e përmendura në pikat “a”, “b”, “c” dhe “d”;
- f) të gjykojë dhe vendosë mbi mosmarrëveshjet e brendshme që lindin midis anëtarëve në shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës ujitëse;
- g) të përfaqësojë dhe mbrojë interesat e anëtarëve të saj.

Neni 6

Parimet e Organizatës

Krijimi dhe veprimtaria e organizatës do të udhëhiqen nga parimet e mëposhtme:

a) *Jodiskriminim*. Organizata nuk do të diskriminojë në mënyrë të padrejtë përsa i përket sigurimit të shërbimeve anëtarë të ndryshëm ose kategori anëtarësh në lidhje me gjininë, besimin ose etninë;

b) *Transparencë dhe pjesëmarrje*. Veprimtaria e organizatës do të bazohet në parimin e transparencës dhe ajo do të nxisë dhe mbështesë pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve të saj;

c) *Drejtësi në marrjen e vendimeve.* Organizata do të përpilojë dhe zbatojë procedura të drejta dhe të barabarta për marrjen e vendimeve, të cilat do të lejojnë të gjithë anëtarët të kenë të drejta të barabarta për të marrë pjesë;

d) *Përdorim i drejtë dhe i barabartë i burimeve.* Organizata do të sigurojë përdorimin e drejtë dhe të barabartë të burimeve, duke përfshirë ujin për ujitje, me qëllim që të plotësojë nevojat e anëtarëve të saj, si dhe përdoruesve të tjerë të ujit, brenda zonës së shërbimit të organizatës; dhe

e) *Përdorim i arsyeshëm i burimeve.* Organizata do të sigurojë përdorimin e arsyeshëm të burimeve në mënyrë që të pengojë humbjen, sasinë e tepërt të ujit, erozionin dhe ndotjen, si dhe të nxisë mbrojtjen e mjedisit.

Neni 7

Anëtarësimi

1. E drejta për të qenë anëtar i një organizate është e lidhur me tokën në pronësi ose në përdorim që ndodhet brenda zonës së shërbimit të ujitjes së organizatës, pavarësisht nga qëllimi i përdorimit dhe transferohet së bashku me tokën deri në momentin kur organizata shpërbëhet ose deri në momentin kur toka nuk përfshihet më brenda zonës së shërbimit të ujitjes. Ushtrimi i të drejtave dhe detyrimeve do të ndërmerret nga çdo person fizik a juridik, pronar toke brenda zonës së shërbimit të ujitjes.

2. Kur një sipërfaqe toke zotërohet nga më shumë se një person, zotëruesit njoftojnë organizatën se cili person ushtron të drejtat dhe detyrimet e anëtarësisë në lidhje me këtë sipërfaqe toke, për të shlyer çdo detyrim dhe tarifë ndaj organizatës.

3. Kur një sipërfaqe toke përdoret nga një person që nuk është pronari i saj, ky i fundit njofton organizatën me shkrim që përdoruesi të jetë anëtar i organizatës për sa i përket asaj sipërfaqe toke, me qëllim mbarrëvajtjen e marrëdhënieve me organizatën. Në çdo rast zotëruesi i vërtetë është përgjegjës deri në fund për shlyerjen e çdo detyrimi apo tarife të pashlyer.

Neni 8

Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të organizatës

1. Anëtar i organizatës ka të drejtë:

- a) të përfitojë nga shërbimet e ofruara nga organizata;
- b) të ketë të drejta të barabarta në furnizimin me ujë për ujitje në dispozicion të organizatës, në proporcion me sasinë e tokës;
- c) të votojë;
- d) të propozojë çështje për diskutim në asamblenë e përgjithshme;
- e) të zgjidhet dhe të propozojë kandidatë për t'u zgjedhur në organet e organizatës;
- f) të marrë pjesë personalisht ose nëpërmjet një përfaqësuesi në mbledhjet e asamblesë së përgjithshme;
- g) të shqyrtojë regjistrat dhe llogaritë e organizatës; dhe
- h) të kompensohet për dëmtimin e tokës së tij dhe të prodhimit në këtë sipërfaqe, si rredhje e veprimtarisë së shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes, të ndërmarra nga organizata në atë tokë.

2. Anëtar i organizatës ka detyrë:

- a) të zbatojë statutin, rregulloren e brendshme dhe vendimet e organizatës;
- b) të paguajë të gjitha detyrimet financiare dhe tarifën e caktuar nga organizata;
- c) të mbrojë pasurinë e organizatës;
- d) të sigurojë informacion për organizatën me kërkesë të saj lidhur me tokën dhe përdorimin e saj; dhe
- e) të lejojë stafin e organizatës të ketë akses në tokën e tij, me ose pa makineri sipas rastit, për kryerjen e veprimeve për mirëmbajtjen e sistemit të ujitjes.

3. Caktimi dhe mbledhja e kuotës vjetore të anëtarësimit realizohet nga organizata.

KAPITULLI III

STRUKTURA ORGANIZATIVE E ORGANIZATËS

Neni 9

Organet përbërëse të organizatës

Organet e organizatës janë:

1. Asambleja e përgjithshme;
2. Këshilli administrativ;
3. Kryetari;
4. Komisioni i auditimit;

Neni 10

Asambleja e përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme, si organi më i lartë vendimmarrës i organizatës, mbledhet të paktën një herë në vit.

2. Mbledhja e asamblesë së përgjithshme thirret nga këshilli administrativ, kur ky i fundit e shih të nevojshme. Mbledhja thirret edhe me kërkesë të, të paktën, 20 për qind të anëtarëve të përfaqësuesve të tyre dhe njoftimi bëhet me shkrim.

3. Vendimet e asamblesë së përgjithshme merren me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm, kur në të marrin pjesë jo më pak se gjysma e tyre.

4. Mbledhjet e asamblesë së përgjithshme drejtohen nga kryetari i organizatës ose, në mungesë të tij nga një person tjetër i caktuar nga këshilli administrativ.

5. Për çdo mbledhje të asamblesë së përgjithshme mbahet proces-verbali përkatës, i cili duhet të firmoset nga kryetari dhe nga një anëtar tjetër i këshillit administrativ.

6. Asambleja e përgjithshme ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- a) zgjedhjen e këshillit administrativ dhe komisionin e auditimit;
- b) miratimin e bilancit vjetor, të raportit vjetor dhe buxhetit të propozuar;
- a) përcakton nivelin e pagave për stafin e organizatës, si dhe fondin rezervë;
- b) miratimin e planit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve ujëtare, si dhe planit të alarmit të evakuimit dhe të ndihmës për mbrojtjen e popullatës e të vlerave materiale, në rastet e jashtëzakonshme, si pasojë e prishjes së digës;
- c) miratimin e programit të shpërndarjes së ujit dhe planit të ujitjes, në funksion të planifikimit vjetor të mbjelljeve;
- ç) miratimin e tarifave dhe detyrimeve që mbliken nga organizata;
- d) propozimin e ndryshimeve në statut;
- dh) miratimin e rregullores së brendshme;

7. Asambleja, me një shumicë prej $\frac{3}{4}$ të të gjithë anëtarëve të saj, mund të vendosë përjashtimin e një anëtari në rastet kur:

- a) nuk shlyejnë detyrimet që lindin nga anëtarësia për një periudhë 6-mujore nga dita që janë bërë të kërkueshme;
- b) dëmtojnë objektet në administrim të organizatës;
- c) abuzojnë me të drejtat që iu njihen nga anëtarësia;
- ç) ndërmarrin akte korruptive me qëllim përfitimi personal;
- d) trajtojnë asetet e organizatës si asete personale dhe kur kryejnë veprime disponimi mbi to (i shesin etj.)

Neni 11

Këshilli administrativ

1. Këshilli administrativ është përgjegjës për administrimin dhe funksionimin e organizatës. Ky këshill jep llogari përpara asamblesë së përgjithshme për mbikëqyrjen e funksionimit të organizatës dhe përbëhet nga një numër tek, minimumi prej tre anëtarësh dhe maksimumi prej njëmbëdhjetë anëtarësh.

2. Anëtarët e këshillit administrativ janë anëtarë të organizatës dhe zgjidhen nga asambleja e përgjithshme në mbledhjen vjetore, për një afat deri në katër vjet, me të drejtë për t'u rizgjedhur. Askush nuk gëzon të drejtën për t'u zgjedhur nëse ka ndaj organizatës detyrime financiare. Çdo anëtar i këshillit administrativ, në çdo moment, vepron në interes të organizatës, duke deklaruar çdo interes financiar, personal, për çështjet që shtrohen për diskutim në mbledhjet e këshillit dhe, në këtë rast, nuk merr pjesë në diskutim.

3. Detyrat e këshillit administrativ janë:

- a) Thirrja e mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme;
- b) Përgatitja e projekt-buxhetit, planit të punës, planit të shfrytëzimit, mirëmbajtjes, planit të alarmit të evakuimit dhe të ndihmës për mbrojtjen e popullatës dhe të vlerave materiale, në rastet e jashtëzakonshme, si pasojë e prishjes së digës, për t'ia kaluar për miratim asamblesë së përgjithshme;
- c) Përgatitja e kontratave, në përputhje me buxhetin e miratuar, me planin e punës dhe me planin e shfrytëzimit e të mirëmbajtjes;
- d) Rekrutimi dhe shkarkimi i administratorit të organizatës;
- e) Propozimi i çështjeve që do të vendosen nga asambleja e përgjithshme;
- f) Monitorimi i funksionimit të organizatës;
- g) Ndjekja e zbatimit të procedurave financiare të organizatës.

5. Mbledhjet e këshillit administrativ zhvillohen çdo muaj. Mbledhjet thirren sipas kërkesës së kryetarit ose në mungesë të tij, zëvendëskryetarit ose një të tretës së anëtarëve të këshillit administrativ. Vendimet e këtij këshilli merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm dhe vota e kryetarit është vendimtare në rast barazie votash. Numri minimal i anëtarëve të këshillit administrativ, që duhet të jenë të pranishëm për fillimin e mbledhjes, është 75 % të antarëve.

6. Në çdo mbledhje të këshillit administrativ do të mbahet procesverbali përkatës, i cili duhet të firmoset nga kryetari dhe nga një antar tjetër i KA-së.

7. Asambleja e përgjithshme voton për shkarkimin nga detyra të anëtarëve të këshillit administrativ, kryetarit, etj., për:

- a) shkelje të rëndë të detyrës;
- b) mospjesëmarrje të përsëritur në mbledhjet e programuara;
- c) kur janë shpallur fajtorë për një vepër penale.
- ç) mosshlyerje e detyrimeve që lindin nga anëtarësia për një periudhë 6-mujore nga dita që janë bërë të kërkueshme.

Neni 12

Kryetari

1. Kryetari i organizatës zgjidhet nga këshilli administrativ prej anëtarëve të tij.
2. Kryetari i organizatës është njëkohësisht edhe kryetari i këshillit administrativ.
3. Kryetari ka këto detyra dhe përgjegjësi:
 - a) Thërret dhe kryeson mbledhjet e këshillit administrativ dhe asamblesë së përgjithshme;
 - b) Përfaqëson organizatën në marrëdhëniet me të tretët;
 - c) Nënshkruan kontrata dhe dokumente të tjera ligjore, në përputhje me vendimet e këshillit administrativ.

Neni 13
Komisioni i auditimit

1. Komisioni i auditimit përbëhet nga kryetari dhe dy anëtarë që zgjidhen nga asambleja e përgjithshme për një periudhë katërvjeçare. Anëtarët e komisionit të auditimit mund të rizgjidhen vetëm një herë.

2. Komisioni i auditimit ka për detyrë të kontrollojë, në vazhdimësi, veprimtarinë ekonomiko-financiare të organizatës dhe të raportojë në mbledhjen vjetore të asamblesë së përgjithshme.

3. Pas miratimit në këtë asamble, ky raport i dërgohet bashkisë dhe drejtorisë së ujitjes dhe kullimit.

4. Largimi nga detyra i anëtarëve të komisionit të auditimit bëhet për të njëjtat shkaqe të përcaktuara në pikën 7 të nenit 11 të statutit.

KAPITULLI IV
TË ARDHURAT E ORGANIZATËS

Neni 14
Burimet e të ardhurave të organizatës

1. Burimet e të ardhurave të organizatës janë:

- a) tarifa vjetore e mirëmbajtjes;¹
- b) tarifa e shërbimit të ujitjes;
- c) dhurimet ose grantet;
- ç) burime të tjera, që nuk bien ndesh me ligjin.

2. Organizata krijon një fond rezervë, ku depozitohen të gjitha bilancet pozitive të të ardhurave, të cilat do të përdoren për riparime emergjence dhe rehabilitim të infrastrukturës së ujitjes.

3. Mbledhja e tarifës vjetore të mirëmbajtjes dhe të shërbimit të ujitjes realizohet nga organizata.

Neni 15
Tarifa vjetore e mirëmbajtjes

1. Organizata mbledh tarifën vjetore të mirëmbajtjes për çdo sipërfaqe toke, brenda zonës së saj të shërbimit të ujitjes. Afati i pagesës së kësaj tarife është brenda datës 31 janar të çdo viti.

2. Tarifa vjetore e mirëmbajtjes i njoftohet me shkrim zotëruesit të tokës dhe përllogaritet duke iu referuar madhësisë të asaj sipërfaqe, në përpjestim me madhësinë totale të zonës së shërbimit të ujitjes.

3. Kjo tarifë përfshin:

- a) shpenzimet e mirëmbajtjes vjetore të sistemit të ujitjes, përgatitjes së tij për stinën e ardhshme të ujitjes dhe kostos së pastrimit të kanaleve kullues të trasferuara;
- b) pjesën për fondin rezervë të organizatës.

Neni 16
Tarifa e shërbimit të ujitjes

1. Organizata vendos një tarifë shërbimi për çdo shpërndarje të ujit për ujitje në bazë të kërkesës së çdo anëtar.

¹ Organizata ka për detyrë që në nenin 15 dhe 16 statutit të përcaktojë tarifat e parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 1 të nenit 34 të ligjit, kjo në zbatim të pikës 3 të nenit 34 të ligjit nr. 24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe kullimit”.

2. Tarifa e shërbimit të ujitjes llogaritet mbi bazën e:
 - a) sipërfaqes së ujitur dhe numrit të ujitjeve, ose;
 - b) vëllimit të ujit të përdorur për çdo ujitje; ose
 - c) kohëzgjatjes së ujitjes dhe çmimit për njësi kohe.
3. Tarifa e shërbimit të ujitjes për njësi përlllogaritet duke iu referuar shpenzimeve të organizatës për shfrytëzimin e sistemit të ujitjes dhe të shpërndarjes së ujit për ujitje, përfshirë çdo shpenzim të bërë nga organizata për nxjerrjen dhe/ose furnizimin e një rezerve të tillë ujore.

Neni 17 **Regjistrimi**

Pas miratimit të statutit nga bashkia, organizata regjistrohet në gjykatën kompetente. Me regjistrimin në gjykatë, organizata fiton statusin juridik.

Neni 18 **Ndryshimi i statutit**

1. Organizata, me vendim të dy të tretave të të gjithë anëtarëve të asamblesë së përgjithshme, vendos ndryshimin e statutit.
2. Vendimi i asamblesë së përgjithshme i dorëzohet bashkisë përkatëse për miratim, së bashku me një kërkesë me shkrim dhe një kopje të statutit, që përmban ndryshimet e propozuara. Brenda 30 ditëve nga marrja e tij, bashkia duhet ta miratojë ose të kërkojë ndryshimin e dispozitave, që nuk janë në përputhje me këtë ligj.

Neni 19 **Shpërndarja dhe likuidimi i organizatës**

1. Organizata mund të shpërndahet:
 - a) me vendim të mbledhjes së përgjithshme të anëtarëve të saj;
 - b) detyrat e saj nuk ekzistojnë më;
 - c) detyrat e saj praktikisht nuk mund të përmbushen më;
 - d) raste të tjera të parashikuara nga ligji.
2. Asambleja e përgjithshme e një organizate, me dy të tretat e votave të gjithë anëtarëve të saj, vendos që organizata të shpërndahet. Vendimi i asamblesë për shpërndarjen e organizatës i njoftohet bashkisë dhe më pas organizata ndjek procedurat e likuidimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Gjykata, në rastet e parashikuara në ligj, mund të vendosë shpërndarjen e organizatës me kërkesë të çdo anëtarit të organizatës, të organeve vendimarrëse të saj, si dhe organeve kompetente shtetërore.

KAPITULLI V MBIKËQYRJA E ORGANIZATËS

Neni 20 **Regjistrat e organizatës**

1. Organizata do të mbajë dokumentet e mëposhtme:
 - a) regjistrin e anëtarëve, i cili përshkruan madhësinë dhe vendndodhjen e pronës së çdo pronari; regjistri rishikohet çdo vit;
 - b) planimetrinë që tregon zonën nën ujitje dhe nën kullim;
 - c) regjistrin për sasinë e ujit të marrë prej organizatës;

- ç) regjistrin për sasinë e ujit ose numrin e ujitjeve të përfituara nga anëtarët;
- d) regjistrin për pagesat e detyruara, tarifat për t'u paguar dhe ato të paguara;
- dh) inventarin e pasurive;
- e) regjistrin për inspektimet dhe kontrollet e infrastrukturës së ujitjes, si dhe regjistrin për inspektimet dhe kontrollet e digës, sipas legjislacionit përkatës.

Neni 21

Kontrolli financiar i llogarive dhe i të ardhurave vjetore

1. Llogaritë e organizatës, që përfshijnë bilancin vjetor dhe raportin e të ardhurave dhe shpenzimeve, u nënshtrohen kontrollit/auditimit vjetor nga bashkia.
2. Kontrolli/auditimi kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për auditimin e brendshëm në sektorin publik.

Neni 22

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij statuti, e lindur gjatë kohëzgjatjes së kësaj organizate, zgjidhet në gjykatën kompetente.

KAPITULLI VI

Neni 23

Dispozita të fundit

Për sa nuk janë parashikuar në këtë statut, janë të vlefshme dispozitat e ligjit nr. 24/2017, datë 9.3.2017, "Për administrimin e ujitjes dhe kullimit" dhe legjislacionit në fuqi.

Të gjithë të anëtarësuarit duhet të njohin këtë statut, duke e aprovuar dhe nënshkruar në çdo pjesë të tij.

Komiteti Themelues i Organizatës së Përdoruesve të Ujit _____

- 1.
- 2.
- 3.
- ...
- 10.

Vendimi i Këshillit Bashkiak _____ nr. _____, datë _____

Ky statut është hartuar në 2 (dy) kopje origjinale.